



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 gusht 2024
Nr. Ref.: RK 2518/24

VENDIM PËR REFUZIMIN E KËRKESËS

në

rastin nr. KI113/24

Parashtrues

Ivana Stojanović

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së tejzgjatjes së pretenduar të procedurës
gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar, dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ivana Stojanović nga Nishi, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Në kërkesën e saj, parashtruesja kërkon nga Gjykata të vlerësojë kohëzgjatjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i pretenduar i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila cenon të drejtat e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe në rregullin 29 (Llogaritja e periudhës kohore) paragrafi (1) (g), rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe rregullin 48 (Vendimet e Gjykatës) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 maj 2024, parashtruesja e kërkesës përmes postës elektronike e dërgoi kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 22 maj 2024, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [nr. GJR. KI113/24] caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban, anëtarë.
7. Më 24 maj 2024, Gjykata përmes postës elektronike njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe njëkohësisht kërkoi nga ajo: **i**) të plotësojë në mënyrë të qartë formularin standard të kërkesës; **ii**) të dorëzojë në Gjykatë dëshminë për kërkesëpadinë që pretendohet se është paraqitur në Gjykatën Themelore në Prishtinë; **iii**) të dorëzojë në Gjykatë të gjitha dokumentet përkatëse në bazë të të cilave Gjykata do të mund të vazhdonte më tutje me shqyrtimin e kërkesës në kuptimin procedural.
8. Më 12 qershor 2024, parashtruesja e kërkesës, gjithashtu përmes postës elektronike, dërgoi një formular standard të kërkesës i cili ishte plotësuar pjesërisht.
9. Më 17 korrik 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Gjykata, bazuar në informatat e disponueshme nga formulari i kërkesës i cili ishte plotësuar pjesërisht, mund të vërejë vetëm se parashtruesja e kërkesës, siç pretendohet, më 7 shtator 2021, paraqiti kërkesëpadinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Meqenëse Gjykata Themelore në Prishtinë, sipas pretendimeve të saj, nuk

veproi sipas kërkesëpadisë, parashtruesja e kërkesës i dërgoi një shkresë zyrtarit për qasje në dokumente publike.

11. Parashtruesja e kërkesës, sipas pretendimeve të saj, më 26 mars 2024, përmes postës elektronike, pranoi një përgjigje nga zyrtari për qasje në dokumente publike, në të cilën thuhet se, *“lënda e saj është regjistruar me numrin C. nr. 7232/2021, dhe më datën 25.09.2023, i është caktuar gjyqtarit për procedim të mëtejshëm”*.

Pretendimet e parashtruesit

12. Në bazë të pretendimeve, Gjykata mund të konstatojë vetëm se parashtruesja e kërkesës ankohet për kohëzgjatjen e procedurës në Gjykatën Themelore dhe se në këtë mënyrë cenohen të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
13. Në mbështetje të kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se, *“gjyqtari të cilit i ishte caktuar kjo lëndë ka qenë i detyruar të caktojë shqyrtimin gjyqësor brenda afatit prej 45 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë, siç thuhet në faqen e internetit të gjykatës, por ai nuk e bëri këtë”*.
14. Në kërkesën e saj, parashtruesja nuk specifikoi se çfarë kërkon nga Gjykata.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Dispozitat përkatëse të Ligjit dhe Rregullores së punës

Ligji

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Rregullorja e punës

Rregulli 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve)

[...]
(c) autorizimin për përfaqësim;
(d) emrin dhe adresën e palës ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet;
(e) mbrojtjen juridike të kërkuar;
(f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve;
(g) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës; dhe
(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.”

[...]

Rregulli 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

(2) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se:

(a) kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose të qartësojë kërkesën;

[...]”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

16. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

17. Megjithatë, përtej kriterëve të përcaktuara më lart, në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret për vlerësimin e kërkesës së tij, Gjykata rikujton nenin 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashihen në nenin 48 të Ligjit, që përcakton:

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

18. Përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret e rregullit 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës, ku parashihet se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësuesin; (d) emrin dhe adresën e palës ose të palëve kundërshtarë, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

19. Në këtë kontekst, sipas paragrafit 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit, që parasheh se nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palën për këtë dhe i cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht

përgjigjen në kërkesë. Në rastet kur palët përkatëse nuk dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Gjykatë apo përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës për të plotësuar apo qartësuar kërkesën dhe e njëjta sërish mbetet e paplotë ose e paqartë, bazuar në rregullin 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër.

20. Në rastin konkret, duke u bazuar në shtjellimin e mësipërm, Gjykata rikujton se në adresën e saj elektronike ka pranuar kërkesën e parashtrueses e cila ishte plotësuar vetëm pjesërisht dhe që në vetvete nuk ishte e mjaftueshme që Gjykata të vazhdojë me procedimin e kërkesës në kuptimin procedural. Më konkretisht, në bazë të një kërkesë të tillë, Gjykata nuk ka mundur të konstatojë, **i)** cili është thelbi i kontestit që pretendohet se është iniciuar nga parashtruesja me paraqitjen e kërkesëpadisë; **ii)** nuk ka mundur të konstatojë nëse fakti se ajo ka paraqitur kërkesëpadinë është i saktë, sepse në Gjykatë nuk është dorëzuar një kopje e kërkesëpadisë që pretendohet se është paraqitur; **iii)** nuk janë dorëzuar as dokumente të tjera që do ta ndihmonin Gjykatën për të kuptuar thelbin e procedurës.
21. Duke pasur parasysh një gjendje të tillë faktike, Gjykata, më 22 maj 2024, i dërgoi një shkresë parashtrueses së kërkesës, në të cilën e informoi të njëjtën se kërkesa e saj është regjistruar në Gjykatë. Me të njëjtën shkresë, Gjykata kërkoi që parashtruesja e kërkesës të plotësojë qartë formularin e kërkesës, të dorëzojë kërkesëpadinë që pretendohet se është paraqitur, si dhe të dorëzojë dokumente të tjera në lidhje me thelbin e procedurës.
22. Gjykata në mënyrë specifike thekson faktin se parashtruesja e kërkesës, më 12 qershor 2024, përsëri në adresën elektronike të Gjykatës, dërgoi të njëjtin formular të kërkesës, të cilin ajo e plotësoi vetëm pjesërisht me informacione të reja, por nuk dorëzoi një kopje të kërkesëpadisë që pretendohet se është paraqitur në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe dokumente të tjera që do të justifikonin ekzistimin e rastit konkret.
23. Lidhur me këtë, Gjykata vlerëson se shkresa e dërguar parashtrueses së kërkesës ishte mjaft e qartë, ku Gjykata kërkoi nga ajo të dorëzojë kopjen e kërkesëpadisë, formularin e plotësuar të kërkesës me të gjitha informatat relevante, si dhe dokumentet e tjera relevante të parapara me Ligj dhe me Rregullore të punës së Gjykatës. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës, edhe pse e pranoi shkresën e Gjykatës, dështoi të vepronte konkretisht sipas saj, por në vend të kësaj, ajo dërgoi të njëjtin formular të kërkesës së Gjykatës me informata pjesërisht të reja, të cilat, si të tilla, nuk i mundësojnë Gjykatës të vazhdojë me shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës në lidhje me drejtat nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së që pretendohet se janë shkelur, në kontekst të kohëzgjatjes së procedurës.
24. Më konkretisht, Gjykata nuk mund të vlerësojë në mënyrë abstrakte kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, pa pasur para vetes asnjë provë për vërtetësinë e fakteve të deklaruara në një kërkesë të tillë të paplotë.
25. Mosdorëzimi i dokumenteve të nevojshme, bazuar në rregullin 25 të Rregullores së punës, i pamundëson Gjykatës shqyrtimin e një kërkesë.
26. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, kërkesa është e paplotë dhe nuk është qartësuar sepse përfaqësuesi i pretenduar, përkundër kërkesave të Gjykatës, nuk ka dorëzuar në Gjykatë autorizimin e vlefshëm për përfaqësimin e palës të cilin ai pretendon se e përfaqëson (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI25/21](#), parashtruesi i kërkesës [Ymer Koro, si përfaqësues i pretenduar i personave K.Lj. dhe K.B.](#), Vendim për refuzim të kërkesës, i 21 korrikut 2021; dhe [KI137/20](#),

parashtrues i kërkesës Naser Peci, si përfaqësues i pretenduar i S.B., Vendim për refuzim të kërkesës, i 17 dhjetorit 2020).

27. Gjithashtu, Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i deklaron këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesve të kërkesës (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI121/21, parashtrues Bajram Hasani, Vendim për refuzim të kërkesës, i 23 shtatorit 2021, paragrafi 38; KI135/21, parashtrues Isuf Musliu, Vendim për refuzim të kërkesës, i 10 shtatorit 2021, paragrafi 35; dhe KI101/21, parashtrues "N.T.Sh Morina B", Vendim për refuzimin e kërkesës, i 8 shtatorit 2021, paragrafi 36).
28. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses së kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të mungesës së autorizimit formal për përfaqësim dhe moskompletimit të kërkesës me dokumentacionin mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 25 (2) (c), (d), (e), (f), (g), (h) dhe 54 (2) (a) të Rregullores së punës. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 25 (2), (c), (d), (e), (f), (g), (h) dhe 54 (2) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 17 korrik 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërzhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani